



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS ANGLEZE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
PËRKTHIM A-B (1)

Ngarkesa: 3 kredite, 30 orë mësimore në klasë, 30 seminare

Viti / Semestri: Viti I, sem I

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: *Master i shkencave "Përkthim teknik-letrar dhe Interpretim"*,

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Të njohë studentët me teknikat dhe strategjitë bazë të përkthimit. Të konsolidojë aftësitë për kuptimin, përkthimin, redaktimin dhe korrektimin e teksteve nga gjuha amtare në gjuhën B. Të pajisë studentët me njohuritë e nevojshme për analizimin e niveleve të ndryshme të zbërthimit të teksteve si hap themelor për përkthimin e saktë.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të zhvillojë përmes ushtrimeve aftësitë për përkthimin e dukurive gramatikore, leksikore dhe stilistike sipas stilit funksional të tekstit.
2. Të përmirësojë shpejtësinë në përkthimin e teksteve pragmatike dhe cilësinë në përkthimin e teksteve paraletrare.
3. Të trajtojë përkthimin si proces praktik dhe ndërdisiplinor.

Rezultatet e pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të analizojnë marrëdhënien midis gjuhës burimore dhe gjuhës së synuar.
2. Do të përdorin në mënyrë të pavarur dhe të saktë instrumentet e referencës gjatë përkthimit.
3. Do të zhvillojnë aftësi për të kuptuar, përkthyer dhe redaktuar tekste të natyrave të ndryshme.
4. Do të përvetësojnë një metodologji të qartë pune në përkthim, duke zbatuar në mënyrë koherente të gjitha fazat e nevojshme të procesit.